

II (Informacion)

INFORMACION NGA INSTITUCIONET, ORGANET, ZYRAT DHE AGJENCITË E BASHKIMIT EVROPIAN KOMISIONI EUROPIAN

Komunikatë e Komisionit për ndihmën shtetërore për filmat dhe veprat e tjera audiovizive

**(Tekst me rëndësi për ZEE)
(2013/C 332/01)**

HYRJE

Veprat audiovizuale, veçanërisht filmat, luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e identiteteve evropiane. Ato pasqyrojnë diversitetin kulturor të traditave dhe historive të ndryshme të shteteve dhe rajoneve anëtare të BE-së. Veprat audiovizuale janë të mira ekonomike që ofrojnë mundësi të rëndësishme për krijimin e pasurisë dhe punësimit, si dhe të mira kulturore që pasqyrojnë dhe formësojnë shoqëritë tona. Ndër veprat audiovizuale, filmat kanë ende një rëndësi të veçantë, për shkak të kostos së prodhimit dhe rëndësisë kulturore. Buxhetet e prodhimit të filmave janë dukshëm më të larta se buxhetet për përmbajtjet e tjera audiovizive, ata janë më shpesh objekt bashkëproduksionesh ndërkombëtare dhe kohëzgjatja e jetës së tyre të shfrytëzimit është më e gjatë. Filmat në veçanti përballen me konkurrencë të fortë nga jashtë Evropës. Nga ana tjetër, nuk ka ndonjë qarkullim të madh të veprave audiovizive evropiane jashtë vendit të tyre të origjinës.

Ky qarkullim i kufizuar rezulton nga fragmentimi i sektorit audioviziv evropian në tregjet kombëtare apo edhe në ato rajonale. Megjithëse kjo lidhet me diversitetin gjuhësor dhe kulturor të Evropës, afërsia mes tyre ndërtohet edhe përmes mbështetjes publike për veprat audiovizive evropiane, me të cilat skemat e financimit kombëtar, rajonal dhe lokal subvencionojnë shumë kompani të vogla produksioni.

Në përgjithësi pranohet se ndihma është e rëndësishme për të mbështetur prodhimin audiovizual evropian. Është e vështirë për producentët e filmave që të marrin nivel të mjaftueshëm mbështetjeje komerciale paraprake për të krijuar një paketë financiare që mundëson vazhdimësinë e projekteve të produksionit. Rreziku i lartë që lidhet me bizneset dhe me projektet e tyre, së bashku me mungesën e perceptuar të përfitimit të këtij sektori, e bëjnë atë të varur nga ndihma shtetërore. Nëse thjesht do t'i lireshin në dorë tregut, shumë prej filmave nuk do të ishin realizuar për shkak të investimeve të mëdha që kërkojnë dhe audiencës së kufizuar për veprat audiovizive evropiane. Në këto rrethana, nxitja e prodhimit audiovizual nga Komisioni dhe nga Shtetet Anëtare duhet të luajë një rol që garanton shprehjen e kulturës dhe

kapacitetit të tyre krijues dhe pasqyrimin e diversitetit dhe pasurisë së kulturës evropiane.

MEDIA, programi i Bashkimit Evropian që mbështet industrinë e filmit, televizionit dhe mediave të reja, ofron një sërë skemash financimi, secila prej të cilave synon fusha të ndryshme të sektorit audioviziv, duke përfshirë skemat për producentët, distributorët, agjentët e shitjeve, organizatorët e kurseve të trajnimit, operatorët e teknologjive të reja dixhitale, operatorët e platformave video-on-demand (VoD), ekspozuesit dhe organizatorët e festivaleve, tregjeve dhe eventeve promovuese. Ky program nxit qarkullimin dhe promovimin e filmave evropianë me theks të veçantë tek filmat evropianë jokombëtarë. Këto masa do të vazhdojnë me nënprogramin MEDIA në kuadër të Creative Europe, programi i ri evropian i mbështetjes për sektorët kulturorë dhe krijues.

PSE DUHET TË KONTROLLOHET NDIHMA SHTETËRORE PËR FILMAT DHE PRODUKTE TË TJERA AUDIOVIZUALE?

Shtetet Anëtare kanë zbatuar një gamë të gjerë masash mbështetëse për prodhimin e filmave, programeve televizive dhe veprave të tjera audiovizuale. Të gjitha bashkë, Shtetet Anëtare ofrojnë rreth 3 miliardë euro mbështetje për filmat në vit ⁽¹⁾. Ky financim sigurohet nëpërmjet më shumë se 600 skemave mbështetëse kombëtare, rajonale dhe lokale. Logjika e këtyre masave bazohet tek aspektet kulturore dhe industriale. Ato kanë si synim kryesor të sigurojnë që kulturat kombëtare dhe rajonale dhe potenciali i tyre krijues të shprehen në mediat audiovizive të filmit dhe televizionit. Nga ana tjetër, ato synojnë të gjenerojnë një masë kritike aktiviteteve të nevojshme për të krijuar dinamikën e zhvillimit dhe konsolidimit të industrisë nëpërmjet krijimit të sipërmarrjeve të produksionit me bazë të shëndoshë dhe zhvillimit të një grupi të përhershëm aftësish dhe përvoj[njerëzore.

Me këtë mbështetje, BE-ja është bërë një nga producentët më të mëdhenj të filmave në botë. Industria e kinemasë e BE-së prodhoi 1 299 filma artistikë në vitin 2012 krahasuar me 817 në SHBA (2011), ose me 1 255 në Indi (2011). Në vitin 2012, Evropa numëroi 933,3 milionë hyrje në kinema ⁽²⁾. Në vitin 2008, tregu audiovizual evropian për argëtimin filmik vlerësohej në shumën prej 17 miliardë eurosh ⁽³⁾. Mbi një milion persona janë të punësuar në sektorin audiovizual në Bashkimin Evropian ⁽⁴⁾.

¹ 2,1 miliardë euro mbështetje sigurohet çdo vit nga fondet evropiane të filmit (<http://www.obs.coe.int/about/oea/pr/fundingreport2011.html>). Sipas studimit mbi ndikimin ekonomik dhe kulturor të kushteve territoriale në skemat e mbështetjes së filmit, rreth 1 miliard euro të tjera sigurohen çdo vit nga Shtetet Anëtare nëpërmjet stimujve tatimorë të filmit

² Burimi: *Focus 2012 – Trendet e tregut botëror të filmit*, Observatori Audiovizual Evropian, maj 2012.

³ PWC Global Entertainment and Media Outlook 2009-2013, qershor 2009, f. 193

⁴ Studim nga KEA për Çështjet Evropiane, Licencimi Multi-Territorial i Punëve Audiovizuale në Bashkimin Evropian, Raport Përfundimtar i përgatitur për Komisionin Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Shoqërinë e Informacionit dhe Mediat, Tetor

Kjo e bën prodhimin dhe shpërndarjen e filmit jo vetëm një aktivitet kulturor, por edhe një aktivitet të rëndësishëm ekonomik. Për më tepër, producentët e filmave janë aktivë në nivel ndërkombëtar dhe veprat audiovizuale tregtohen ndërkombëtarisht. Kjo do të thotë se një ndihmë e tillë në formën e granteve, stimujve tatimorë ose llojeve të tjera të mbështetjes financiare mund të ndikojë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Producentët dhe veprat audiovizive që e marrin një mbështetje të tillë ka të ngjarë të kenë një avantazh financiar dhe, si rrjedhim, edhe konkurrues ndaj atyre që nuk e marrin. Rrjedhimisht, një mbështetje e tillë mund ta shtrembërojë konkurrencën dhe të konsiderohet si ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 107(1) të TFBE-së. Prandaj, sipas nenit 108 të TFBE-së, Komisioni është i detyruar të vlerësojë se sa përputhet kjo ndihmë që i jepet sektorit audioviziv me tregun e brendshëm, siç bën me masat e ndihmës shtetërore në sektorë të tjerë. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se Traktati e vlerëson rëndësinë e madhe që ka promovimi i kulturës për Bashkimin Evropian dhe për Shtetet e tij Anëtare, duke e përfshirë kulturën midis politikave të Bashkimit Evropian, referuar në mënyrë specifike në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Neni 167(2) i TFBE-së parashikon se:

“Masat e Bashkimit Evropian do të kenë për qëllim të nxisin bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, të mbështetin dhe të plotësojnë masat e ndërmarra nga vetë shtetet në këto fusha:

[...]

— krijimin artistik dhe letrar, duke përfshirë edhe sektorin audiovizual.’

Neni 167(4) i TFBE-së parashikon se:

"Bashkimi Evropian do të marrë parasysh aspektet kulturore në masat që do të ndërmarrë në kuadrin e dispozitave të tjera të Traktateve, veçanërisht për të respektuar dhe për të promovuar diversitetin e kulturave të tij."

Neni 107(1) i TFBE-së ndalon ndihmën e dhënë nga shteti ose nga burime shtetërore, që shtrembërojnë ose kërcënojnë të shtrembërojnë konkurrencën dhe tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Megjithatë, Komisioni mund t'i përjashtojë disa lloje ndihme shtetërore nga ky ndalim. Një nga këto përjashtime është neni 107(3)(d) i TFBE-së për ndihmën për promovimin e kulturës, kur një ndihmë e tillë nuk ndikon në kushtet e konkurrencës dhe tregtisë në atë masë saqë të bjerë në kundërshtim me interesin e përbashkët.

Rregullat e Traktatit për kontrollin e ndihmës shtetërore njohin specifikat e kulturës dhe aktivitetet ekonomike që lidhen me të. Ndihma

audiovizuale kontribuon në qëndrueshmërinë afatmesme deri në qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorëve evropianë të filmit dhe sektorit audiovizual në të gjitha Shtetet Anëtare dhe rrit diversitetin kulturor të veprave të disponueshme për audiencën evropiane.

Si Palë e Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore, Bashkimi Evropian, së bashku me Shtetet Anëtare të BE-së, është i përkushtuar ta integrojë dimensionin kulturor si një element jetik në politikat e tij.

ZHVILLIMET QË PREJ VITIT 2001

Kriteret e vlerësimit për ndihmën shtetërore për prodhimin e filmave dhe të veprave të tjera audiovizuale janë përcaktuar fillimisht në Komunikimin për Kinemanë të vitit 2001 ⁽¹⁾. Këto kriterë vazhduan të ishin të vlefshme edhe në vitin 2004 ⁽²⁾, 2007 ⁽³⁾ dhe në 2009-ën ⁽⁴⁾ dhe rreshtën së qeni të vlefshme më 31 dhjetor 2012. Ky Komunikim ndjek linjat kryesore të Komunikimit të vitit 2001, ndërkohë që i përgjigjet një sërë tendencash që janë shfaqur që nga viti 2001.

Skemat e ndihmës të miratuara nga Komisioni që nga hyrja në fuqi e rregullave të vitit 2001 tregojnë se Shtetet Anëtare përdorin një shumëllojshmëri të gjerë mekanizmesh dhe kushtesh ndihme. Shumica e skemave ndjekin modelin për të cilin janë hartuar kriteret e vlerësimit të Komunikimit të 2001, përkatësisht grantet e dhëna për produksionet e përzgjedhura filmike, ku ndihma maksimale përcaktohet si një përqindje e buxhetit të produksionit të përfituesit të ndihmës. Megjithatë, një numër gjithmonë e më i madh Shtetesh Anëtare po miratojnë skema, ku shuma e ndihmës përcaktohet si përqindje e shpenzimeve për aktivitetin e produksionit të ndërmarrë vetëm në shtetin anëtar që e jep ndihmën. Këto skema shpesh hartohen në formën e uljes së taksave ose në një mënyrë që aplikohet automatikisht për filmat që plotësojnë disa kriterë të caktuar të vendosura për dhënien e asaj ndihme. Krahësuar me fondet e filmit që konsistojnë në mbështetje individuale të filmave të caktuar pas një procesi aplikimi, këto skema me aplikimin e tyre automatik u lejojnë producentëve të filmave që të llogarisin se mund të marrin një sasi të parashikueshme financimi që në fazën e planifikimit dhe zhvillimit të filmit.

Sa i përket fushës së aktiviteteve të mbështetura, disa Shtete Anëtare ofrojnë ndihmë edhe për aktivitete të tjera përveçse për prodhimin e filmave. Këtu përfshihet edhe ndihma që jepet për shpërndarjen e filmave ose për kinematë, si për shembull për të mbështetur kinematë

¹ Komunikimi për filmin nga Komisioni drejtuar Këshillit, Parlamentit Evropian, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve mbi disa aspekte ligjore që lidhen me veprat kinematografike dhe me veprat e tjera audiovizive (OJ C 43, 16.2.2002, f. 6).

² OJ C 123, 30.4.2004, f. 1.

³ OJ C 134, 16.6.2007, f. 5.

⁴ OJ C 31, 7.2.2009, f. 1.

rurale ose kinematë e artit në përgjithësi ose për të mbuluar rinovimin dhe modernizimin e tyre, duke përfshirë edhe kalimin e tyre në projektimin dixhital. Disa Shtete Anëtare mbështesin projektet audiovizuale që shkojnë përtej konceptit tradicional të prodhimeve filmike dhe televizive, sidomos produkte interaktive si transmedian ose lojërat. Në këto raste, Komisioni ka aplikuar kriteret e Komunikimit për Kinemanë si referencë për të vlerësuar domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e ndihmës, sa herë vihej në dijeni të ndihmave të tilla. Komisioni ka vënë gjithashtu në dukje edhe një konkurrencë mes Shteteve Anëtare në përdorimin e ndihmës shtetërore për të tërhequr në vend investime nga kompani të mëdha të prodhimit të filmave të vendeve të treta. Këto çështje nuk janë adresuar në Komunikimin e vitit 2001.

Që në Komunikimin e 2001-shit u njoftua se Komisioni do ta rishikonte nivelin maksimal të detyrimeve territoriale të shpenzimeve në këtë sektor që lejoheshin sipas rregullave të ndihmës shtetërore. Detyrimet territoriale të shpenzimeve në skemat e financimit të filmit kërkojnë që një pjesë e caktuar e buxhetit të filmit të mbështetur të shpenzohet në shtetin anëtar që jep ndihmën. Shtrirja e tyre deri në vitin 2004 identifikoi detyrimet e shpenzimeve territoriale në skemat e financimit të filmave si një çështje që duhet të vlerësohet më tej në funksion të përputhshmërisë së saj me parimet e tregut të brendshëm të Traktatit. Duhet gjithashtu të merret parasysh edhe praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë, e miratuar që nga viti 2001 mbi rëndësinë e tregut të brendshëm në lidhje me rregullat për origjinën e mallrave dhe shërbimeve ⁽¹⁾.

Gjithashtu, probleme në praktikë ka ngritur edhe aplikimi i 'testit kulturor'. Se sa është ndihma në përputhje me prodhimin e filmit vlerësohet sipas nenit 107(3)(d) të TFBE-së, i cili parashikon mundësinë e dhënies së ndihmës "për promovimin e kulturës". Komunikimi i vitit 2001 kërkonte që ndihma të orientohej drejt një produkti kulturor. Megjithatë, shqyrtimi i hollësishëm nga Komisioni i kriterëve kulturore në skemat e mbështetjes së filmit ka qenë një pikë polemike me Shtetet Anëtare, veçanërisht sa i përket parimit të subsidiaritetit.

Prandaj, kur kriteret e vlerësimit të ndihmës shtetërore të Komunikimit të Kinemasë të vitit 2001 u shtrinë deri në 2009-ën, Komisioni vuri në dukje nevojën për reflektim të mëtejshëm mbi implikimet e këtyre zhvillimeve dhe për një rishikim të kriterëve të vlerësimit.

4. NDRYSHIME SPECIFIKE

Në këtë Komunikim trajtohen çështjet e mësipërme dhe paraqiten ndryshimet në kriteret e Komunikimit të vitit 2001. Në veçanti, ky komunikim mbulon ndihmën shtetërore për një fushë më të gjerë

¹ Në veçanti, Aktgjykimi i Gjykatës së Drejtësisë i datës 10 mars 2005 në çështjen Laboratoires Fournier (C-39/04), ECR 2005 I-2057.

aktivitetesh, thekson parimin e subsidiaritetit në fushën e politikës kulturore dhe respektimin e parimeve të tregut të brendshëm, prezanton një nivel më të lartë të intensitetit maksimal të ndihmës për prodhimet ndërkufitare dhe kujdeset për mbrojtjen e trashëgimisë filmike dhe për aksesin në të. Komisioni beson se këto ndryshime janë të nevojshme duke pasur parasysh zhvillimet që nga viti 2001 dhe do të ndihmojnë që veprat evropiane të jenë më konkurruese dhe panevropiane në të ardhmen.

Fusha e aktiviteteve

Për sa i përket fushës së aktiviteteve për të cilat zbatohet kjo komunikatë, kriteret e ndihmës shtetërore të Komunikimit të vitit 2001 për Kinematografinë fokusoheshin në prodhimin e filmave. Megjithatë, siç përmendet më sipër, disa Shtete Anëtare ofrojnë mbështetje edhe për aktivitete të tjera që lidhen me të, si për shkrim skenaresh, zhvillim, shpërndarje dhe promovim filmash (duke përfshirë edhe festivalet e filmit). Objektivi i mbrojtjes dhe promovimit të diversitetit kulturor të Evropës përmes veprave audiovizuale mund të arrihet vetëm nëse këto vepra shihen nga audienca. Ndihma e ofruar vetëm për produksion rrezikon të stimulojë furnizimin me përmbajtje audiovizuale pa u siguruar që këto vepra audiovizuale që vijnë si rrjedhim shpërndahen dhe promovohen siç duhet. Prandaj, është e udhës që ndihma të mund të mbulojë të gjitha aspektet e krijimit të një filmi, nga konceptimi i subjektit deri tek shpërndarja tek audienca.

Në lidhje me ndihmën për kinematë, shumat janë zakonisht të vogla, kështu që për shembull kinematë rurale dhe ato të artit duhet të përfitojnë mjaftueshëm nga nivelet e ndihmës që parashikon Rregullorja *de minimis* ⁽¹⁾. Megjithatë, nëse një Shtet Anëtar mund të shpjegojë nevojën për më shumë mbështetje për kinematë, kjo ndihmë do të vlerësohet sipas këtij Komunikimi si ndihmë për promovimin e kulturës në kuptimin e nenit 107(3)(d) të TFBE-së. Ndihma për kinematë promovon kulturën sepse qëllimi kryesor i kinemasë është ekspozimi i produktit kulturor të filmit.

Disa Shtete Anëtare kanë parë mundësitë e mbështetjes së disa projekteve audiovizuale që shkojnë përtej konceptit tradicional të prodhimeve filmike dhe televizive. Të treguarit e historive përmes transmedias (i njohur gjithashtu si të treguarit e historive me shumë platforma ose të treguarit e historive në media të ndryshme njëherësh) është teknika e të treguarit të historive nëpër platforma dhe formate të shumta duke përdorur teknologji dixhitale, si filma dhe lojëra. Ajo çka është e rëndësishme është që këto pjesë të përmbajtjes janë të lidhura me njëra-tjetrën ⁽²⁾. Meqenëse projektet transmediale janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me prodhimin e filmit, komponenti i

¹ Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1998/2006 e datës 15 dhjetor 2006 mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit për ndihmën *de minimis* (OJ L 379, 28.12.2006, f. 5)

² Nuk duhet ngatërruar me ekskluzivitetet tradicionale mediatike të platformave të ndryshme, vazhdimet apo me përshtatjet.

prodhimit të filmit konsiderohet si vepër audiovizuale që hyn në këtë fushë Komunikimi.

Nga ana tjetër, edhe pse lojërat mund të përfaqësojnë një nga format me rritjen më të shpejtë të masmedias në vitet e ardhshme, jo të gjitha lojërat kualifikohen domosdoshmërisht si vepra audiovizuale ose si produkte kulturore. Ata kanë karakteristika të tjera në lidhje me prodhimin, shpërndarjen, marketingun dhe konsumin nga filmat. Prandaj, rregullat e krijuara për prodhimin e filmit nuk mund të zbatohen automatikisht për lojërat. Përveç kësaj, ndryshe nga sektori i filmit dhe televizionit, Komisioni nuk ka një masë kritike vendimesh për ndihmën shtetërore për lojërat. Për rrjedhojë, ky Komunikim nuk mbulon ndihmën e dhënë për lojërat. Çdo masë ndihme në mbështetje të lojërave që nuk plotëson kushtet e Rregullores së Përgjithshme të Përfundimit në Bllok (GBER) ⁽¹⁾ ose të Rregullores *de minimis* do të vazhdojë të trajtohet rast pas rasti. Për atë kohë sa mund të demonstrohet domosdoshmëria e një skeme ndihme që ka si objekt lojërat që shërbejnë për një qëllim kulturor ose edukativ, Komisioni do të zbatojë për analogji kriteret e intensitetit të ndihmës të këtij Komunikimi.

Kriteri kulturor

Për të qenë në përputhje me nenin 107(3)(d) TFBE, ndihma për sektorin audioviziv duhet të promovojë kulturën. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit të parashikuar në nenin 5 të TBE-së, përcaktimi i aktiviteteve kulturore është kryesisht përgjegjësi e Shteteve Anëtare. Në vlerësimin e një skeme të mbështetjes audiovizuale, Komisioni pranon se detyra e tij kufizohet në verifikimin nëse një Shtet Anëtar e ka apo jo një mekanizëm verifikimi të përshtatshëm dhe efikas, të aftë për të shmangur gabimet e dukshme. Kjo do të arrihej ose nëpërmjet ekzistencës së një procesi përzgjedhjeje kulturore për të përcaktuar se cilat vepra audiovizuale duhet të përfitojnë nga ndihma ose përmes një profili kulturor që duhet të plotësohet nga të gjitha veprat audiovizive si kusht i ndihmës. Në përputhje me Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjes Kulturore të vitit 2005 ⁽²⁾, Komisioni vëren se fakti që një film është komercial nuk e pengon atë të jetë kulturor.

Diversiteti gjuhësor është një element i rëndësishëm i diversitetit kulturor; prandaj, edhe mbrojtja dhe promovimi i përdorimit të një ose disa gjuhëve të një shteti anëtar i shërben promovimit të kulturës ⁽³⁾.

¹ Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 800/2008 e datës 6 gusht 2008 që shpall kategori të caktuara ndihme në përputhje me tregun e përbashkët në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit (Rregullorja e Përgjithshme e Përfundimit në Bllok) (OJ L 214, 9.8.2008, f. 3).

² Konventa thotë në nenin 4(4): "Aktivitetet, mallrat dhe shërbimet kulturore u referohen atyre aktiviteteve, mallrave dhe shërbimeve, të cilat ... mishërojnë ose përcjellin shprehje kulturore, pavarësisht nga vlera komerciale që mund të kenë. Aktivitetet kulturore mund të jenë qëllim në vetvete ose mund të kontribuojnë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve kulturore."

³ Aktgjykimi i Gjykatës i datës 5 mars 2009, *UTECA*, Çështja C-222/07, paragrafët 27-33.

Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, si promovimi i gjuhës së një shteti anëtar ⁽¹⁾, ashtu edhe politika kulturore ⁽²⁾ mund të përbëjnë një kërkesë mbizotëruese në lidhje me interesin e përgjithshëm që justifikon një kufizim në lirinë e ofrimit të shërbimeve. Prandaj, shtetet anëtare mund të kërkojnë, si kusht për ndihmën, ndër të tjera, që filmi të prodhohet në një gjuhë të caktuar, kur vërtetohet se kjo kërkesë është e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e një objektivi kulturor në sektorin audiovizual, i cili mund të favorizojë gjithashtu lirinë e shprehjes së komponentëve të ndryshëm shoqërorë, fetarë, filozofikë ose gjuhësorë që ekzistojnë në një rajon të caktuar. Fakti që një kriter i tillë mund të përbëjë në praktikë një avantazh për sipërmarrjet e produksionit të kinemave që punojnë në gjuhën e mbuluar nga ai kriter duket në përputhje me objektivin ⁽³⁾.

Detyrimet territoriale për shpenzimet

Detyrimet e vendosura nga autoritetet që japin ndihmë për producentët e filmave që ata ta shpenzojnë një pjesë të caktuar të buxhetit të prodhimit të filmit në një territor të caktuar (detyrimet e shpenzimeve territoriale) i janë nënshtruar një vëmendjeje të veçantë qëkur Komisioni ka filluar të shqyrtojë skemat e mbështetjes së filmit. Komunikimi i vitit 2001 për kinemanë u ka lejuar shteteve anëtare që të kërkojnë që deri në 80% e të gjithë buxhetit të filmit të shpenzohet në territorin e tyre. Skemat që përcaktojnë shumën e ndihmës si një përqindje të shpenzimeve të aktivitetit të produksionit të ndërmarrë në shtetin anëtar të BE-së që e jep ndihmën përpiqen tashmë që në fazën e dizajnit që të tërheqin sa më shumë aktivitet produksioni në shtetin anëtar që jep ndihmën dhe që në shpenzime të ketë një element të qenësishëm territorializmi. Komunikimi për Kinematografinë duhet të marrë parasysh këto lloje të ndryshme të skemave të ndihmës që ekzistojnë aktualisht.

Detyrimet territoriale për shpenzime përbëjnë një kufizim të tregut të brendshëm për prodhimin audioviziv. Prandaj, Komisioni porosi një studim mbi kushtet territoriale të vendosura ndaj produksioneve audiovizuale të përmbyllura në vitin 2008 ⁽⁴⁾. Siç thuhet në zgjatjen e Komunikimit për Kinemanë të 2009-tës, në përgjithësi, ky studimi nuk kishte qenë përfundimtar: ai nuk arriti të gjykonte nëse efektet pozitive të kushteve territoriale ishin apo jo më të mëdha sesa efektet negative. Megjithatë, ky studim konstatoi se kostot e prodhimit të filmave dukeshin të ishin më të larta në vendet ku aplikoheshin kushte territoriale sesa në ato që nuk vendosnin kushte të tilla. Ky studim zbuloi gjithashtu se kushtet territoriale mund të përbëjnë pengesa për

¹ Aktgjykimi i Gjykatës i 13 dhjetorit 2007, *United Pan-Europe Communications Belgium*, Çështja C-250/06, paragrafi 43.

² Aktgjykimi i Gjykatës i 28 tetorit 1999, *ARD*, Çështja C-6/98, paragrafi 50.

³ Aktgjykimi i Gjykatës i datës 5 mars 2009, *UTECA*, Çështja C-222/07, paragrafët 34, 36.

⁴ Studim i vitit 2008 mbi Ndikimin Ekonomik dhe Kulturor, sidomos tek bashkëproduksionet, të Klauzolave të Territorializimit të skemave të ndihmës shtetërore për filmat dhe produksionet audiovizive (http://ec.europa.eu/avpolicy/docs/library/studies/territ/final_rep.pdf).

bashkëproduksionet dhe mund t'i bëjnë ato më pak efikase. Në përgjithësi, studimi konstatoi se detyrimet më kufizuese territoriale mbi shpenzimet nuk çonin në aq shumë efekte pozitive saqë të justifikonin vazhdimësinë e niveleve aktuale të kufizimeve. Ai gjithashtu tregoi se kushtet e vendosura nuk rezultojnë të domosdoshme për arritjen e objektivave që synoheshin të arriheshin mes tyre.

Një masë kombëtare që pengon ushtrimin e lirive themelore të garantuara nga Traktati mund të jetë e pranueshme vetëm kur plotëson disa kushte: ajo duhet të ndërmerret për një arsye kryesore me interes të përgjithshëm, duhet të jetë e përshtatshme për të siguruar arritjen e objektivit për të cilin ndërmerret dhe nuk duhet të shkojë përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur atë objektiv ⁽¹⁾. Karakteristikat specifike të industrisë së filmit, në veçanti lëvizshmëria ekstreme e produksioneve dhe promovimi i diversitetit kulturor, i kulturës dhe i gjuhëve kombëtare, mund të përbëjnë një kërkesë mbizotëruese me interes të përgjithshëm që mund të justifikojë një kufizim në ushtrimin e lirive themelore. Prandaj, Komisioni vazhdon të pranojë se, në një masë të caktuar, kushte të tilla mund të jenë të nevojshme për të mbajtur një masë kritike të infrastrukturës për prodhimin e filmave në shtetin anëtar ose në rajonin që jep ndihmën. Vështirë të ketë ndonjë Shtet Anëtar që vendos detyrime për shpenzime territoriale deri në kufirin prej 80% të buxhetit të prodhimit të lejuar nga Komunikata e 2001-shit. Disa shtete anëtare nuk kanë fare detyrime për shpenzime territoriale në skemat e tyre. Shumë skema rajonale janë të lidhura me shumën e ndihmës dhe kërkojnë që 100% ose 150% e kësaj shume të shpenzohet në shtetin anëtar që i jep ndihmën, pa specifikuar origjinën e shërbimeve të nënkontraktuara ose origjinën e mallrave të përdorura në produksion. Në disa skema ndihme, producenti që merr ndihmën është i lirë të shpenzojë të paktën 20% të buxhetit të produksionit jashtë atij Shteti Anëtar. Disa Shtete Anëtare e dizenojnë ndihmën që japin për filmat si përqindje vetëm të shpenzimeve lokale.

Shuma e shpenzimeve që u nënshtrohet detyrimeve territoriale duhet të paktën të jetë në proporcion të drejtë me angazhimin aktual financiar të Shtetit Anëtar dhe jo me buxhetin e përgjithshëm të produksionit. Ky nuk ishte domosdoshmërisht rasti me kriterin territorial të Komunikimit të vitit 2001 ⁽²⁾.

Në thelb ekzistojnë dy mekanizma të veçantë ndihme që aplikohen nga Shtetet Anëtare që japin ndihmë për prodhimin e filmave:

— ndihma e dhënë — për shembull nga një panel përzgjedhës — si

¹ Aktgjykimi i UTECA, Çështja C-222/07, §25.

² Për shembull: një producent po bën një film me një buxhet prej 10 milionë eurosh dhe aplikon për ndihmë në një skemë që ofron maksimumi 1 milionë euro për film. Është joproportionale që ky film të përjashtohet nga skema me arsyetimin se producenti nuk pret të shpenzojë të paktën 8 milionë euro nga buxhetit të produksionit në territorin që ofron ndihmën.

grante të drejtpërdrejta, të përcaktuara, për shembull, si përqindje të buxhetit të prodhimit; dhe

— ndihma e dhënë dhe e përcaktuar si përqindje e shpenzimeve të prodhimit në shtetin anëtar që jep ndihmën (p.sh. stimul tatimor).

Paragrafi 50 vendos limitet për çdo mekanizëm brenda të cilit Komisioni mund të pranojë që një Shtet Anëtar të vendosë disa detyrime territoriale për shpenzimet, që mund të konsiderohen ende si të nevojshme dhe në raport të drejtë me një objektiv kulturor.

Në rastin e ndihmës së dhënë në formë granti, detyrimi maksimal territorial për shpenzimet duhet të kufizohet në 160% të shumës së ndihmës. Kjo përkon me rregullin e mëparshëm "80% të buxhetit të prodhimit" kur intensiteti i ndihmës arrin maksimumin e përgjithshëm të përcaktuar në paragrafin 52(2), përkatësisht 50% të buxhetit të prodhimit ⁽¹⁾.

Në rastin e ndihmës së dhënë si përqindje të shpenzimeve për aktivitetin e prodhimit në shtetin anëtar që jep ndihmën, ka një stimul për të shpenzuar më shumë në shtetin anëtar për të marrë më shumë ndihmë. Kufizimi i aktivitetit të prodhimit që plotëson kushtet për mbështetje tek ato aktivitete që zhvillohen në Shtetin Anëtar që jep ndihmën është kufizim territorial. Rrjedhimisht, për të vendosur një kufi që është i krahueshëm me kufirin për grante, shpenzimet maksimale që i nënshtrohen detyrimeve për shpenzimet territoriale janë 80 % e buxhetit të prodhimit.

Përveç kësaj, sipas secilit mekanizëm, çdo skemë mund të ketë një kriter pranueshmërie që kërkon një nivel minimal të aktivitetit të prodhimit në territorin e Shtetit Anëtar që jep ndihmën. Ky nivel nuk duhet të kalojë 50% të buxhetit të prodhimit.

Në çdo rast, sipas ligjit të BE-së, Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara të vendosin detyrime për shpenzimet territoriale.

Konkurrenca për tërheqjen e produksioneve të mëdha të huaja

Kur u miratua Komunikimi për Kinematografinë i vitit 2001, të pakëta ishin shtetet anëtare që u përpoqën të përdornin ndihmën e planifikuar për kinematografinë për të tërhequr projekte të mëdha filmike të huaja që do të prodhoheshin në territorin e tyre. Që atëherë, disa Shtete Anëtare kanë prezantuar disa skema që kanë për qëllim tërheqjen e produksioneve me profil të lartë në Evropë, në konkurrencë globale me

¹ Për shembull: një producent po bën një film me një buxhet prej 10 milionë eurosh dhe aplikon për ndihmë në një skemë që ofron maksimumi 1 milion euro për film. Producenti mund të pritët të shpenzojë vetëm 1,6 milionë euro të buxhetit të prodhimit në territorin ku ofron ndihmën. Megjithatë, nëse buxheti i filmit do të ishte 2 milionë euro dhe nëse ai do të kishte marrë shumën maksimale të ndihmës, producenti do të përballej me një detyrim shpenzimi territorial që korrespondon me 80% të buxhetit të prodhimit.

të tjera vende dhe me të tjera subjekte, si në Australi, Kanada, në Zelandën e Re dhe në Shtetet e Bashkuara. Kontribuesit në konsultimet publike që i paraprinë këtij Komunikimi kanë rënë dakord se këto produksione kenë qenë të nevojshme për të ruajtur një infrastrukturë audiovizive me cilësi të lartë, për të kontribuar në përdorimin e objekteve, pajisjeve dhe stafit të studiove të klasit të lartë dhe për të kontribuar në transferimin e teknologjisë, njohurive dhe ekspertizës. Përdorimi i pjesshëm i objekteve nga produksionet e huaja do të ndihmonte edhe për të pasur kapacitete për realizimin e produksioneve evropiane cilësore dhe të një profili të lartë.

Sa i përket efektit të mundshëm në sektorin audioviziv evropian, produksionet e huaja mund të ketë një ndikim të qëndrueshëm pasi ato zakonisht e përdorin gjerësisht këtë infrastrukturë lokale dhe kastet vendase. Në përgjithësi, kjo mund të ketë një efekt pozitiv në sektorin kombëtar audioviziv. Duhet të theksohet gjithashtu se shumë nga filmat që konsiderohen si projekte të mëdha të vendeve të treta janë në fakt bashkëproduksione që përfshijnë edhe producentë evropianë. Në këtë mënyrë, këto subvencione do të kontribuonin edhe në promovimin e veprave audiovizive evropiane dhe në mirëmbajtjen e objekteve për produksionet kombëtare.

Prandaj, Komisioni gjykon se një ndihmë e tillë mundet që në parim të jetë e pajtueshme me nenin 107(3)(d) të TFBE-së si ndihmë për promovimin e kulturës në të njëjtat kushte si ndihma për produksionet evropiane. Megjithatë, duke qenë se shumtë e ndihmës për produksionet kryesore ndërkombëtare mund të jenë shumë të larta, Komisioni do të monitorojë zhvillimin e mëtejshëm të kësaj lloji ndihme për t'u siguruar që konkurrenca të zhvillohet kryesisht në bazë të cilësisë dhe çmimit, dhe jo në bazë të ndihmës nga shteti.

Produksionet ndërkufitare

Një numër i vogël filmash evropianë shpërndahen jashtë territoreve të tyre të prodhimit. Mundësia që një film evropian të shfaqet në disa shtete anëtare është më e lartë në rastin e bashkëproduksioneve që përfshijnë producentë të ndryshëm nga disa vende ndryshe. Duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit të producentëve nga shtete të ndryshme anëtare për prodhimin e veprave evropiane që shihen në disa shtete anëtare, Komisioni çmon se një intensitet më i lartë ndihme do të ishte i justifikueshëm për bashkëproduksionet e financuara nga më shumë se një shtet anëtar dhe duke përfshirë producentë nga më shumë se një Shtet Anëtar.

Trashëgimia e filmit

Filmat duhet të mblidhen, të ruhen dhe të jenë të aksesueshëm për brezat e ardhshëm për qëllime kulturore dhe edukuese ⁽¹⁾.

¹ Rekomandimi i Parlamentit Evropian dhe Këshillit për trashëgiminë e filmit (OJ L 323, 9.12.2005, f. 57)

Konkluzionet e Këshillit të Arsimit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve mbi trashëgiminë evropiane të filmit të 18 nëntorit 2010 ⁽¹⁾ i ftuan shtetet anëtare të marrin masa që filmat që janë mbështetur me ndihmë shtetërore të depozitohen në një institucion të trashëgimisë së filmit, së bashku me të gjithë materialin përkatës, atë ku është e mundur, dhe bashkë me të drejtat përkatëse që lidhen me ruajtjen dhe me përdorimin kulturor dhe jokomercial të filmave dhe të materialeve përkatëse.

Disa Shtete Anëtare kanë futur praktikën e të paguarit të këstit të fundit të ndihmës pasi institucioni i trashëgimisë së filmit të ketë vërtetuar depozitimën e filmit të cilit i është dhënë ndihma. Ky ka rezultuar të jetë një instrument efikas për zbatimin e detyrimit të depozitimit të parashikuar me kontratë.

Disa shtete anëtare kanë futur gjithashtu edhe disa dispozita në marrëveshjet e tyre të granteve për të lejuar përdorimin e filmave të financuar publikisht për qëllime të specifikuara në përmbushjen e misionëve me interes publik të institucioneve të trashëgimisë së filmit pas një periudhe kohe të rënë dakord dhe me kusht që kjo të mos ndikojë në përdorimin normal të filmit.

Prandaj, Shtetet Anëtare duhet t'i inkurajojnë dhe t'i mbështesin producentët që ta depozitojnë një kopje të filmit të ndihmuar në institucionin e trashëgimisë së filmit të përcaktuar nga organi financues për t'u ruajtur ⁽²⁾, si dhe për përdorim të specifikuar jokomercial siç bihet dakord me mbajtësin(it) e së drejtave të tij në përputhje me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe pa cenuar shpërblimin e drejtë të mbajtësit(ve) të së drejtës pas një periudhe kohore të rënë dakord dhe të përcaktuar në marrëveshjen e grantit dhe në mënyrë të tillë që kjo të mos ndikojë në përdorimin normal të filmit.

VLERËSIMI I PAJTUESHMËRISË SË NDIHMËS

Kur vlerëson ndihmën për filmat dhe për veprat e tjera audiovizive, Komisioni verifikon në bazë të konsideratave të mësipërme.

— Së pari, nëse skema e ndihmës respekton parimin e 'ligjshmërisë së përgjithshme', d.m.th. Komisioni duhet të verifikojë që skema nuk përmban klauzola që do të ishin në kundërshtim me dispozitat e TFBE-së në fusha të tjera përveç ndihmës shtetërore.

— Së dyti, nëse skema përmbush kriteret specifike të përputhshmërisë për ndihmën, të përcaktuara më poshtë.

¹ OJ C 324, 1.12.2010, f. 1.

² Institucionet e Trashëgimisë së Filmit caktohen nga Shtetet Anëtare për koleksionimin, ruajtjen dhe për vënien në dispozicion të trashëgimisë së filmit për qëllime kulturore dhe edukuese. Në zbatim të Rekomandimit të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të vitit 2005 mbi trashëgiminë e filmit, Shtetet Anëtare kanë listuar institucionet e tyre të trashëgimisë së filmit. Kjo lista aktuale gjendet në internet (<http://ec.europa.eu/avpolicy/docs/reg/cinema/institutions.pdf>)

Ligjshmëria e përgjithshme

Komisioni duhet së pari të verifikojë nëse ndihma respekton parimin e 'ligjshmërisë së përgjithshme' dhe nëse kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e dhënies së ndihmës nuk përmbajnë klauzola që bien në kundërshtim me TFBE-në në fusha të tjera përveç ndihmës shtetërore. Kjo përfshin garantimin e respektimit të parimeve të TFBE-së që ndalojnë diskriminimin për shkak të kombësisë, lëvizjes së lirë të mallrave, lëvizjes së lirë të punëtorëve, lirisë së organizimit, lirisë për të ofruar shërbime dhe lirisë së lëvizjes së kapitalit (nenet 18, 34, 36, 45, 49, 54, 56 dhe 63 të TFBE-së). Komisioni i zbaton këto parime bashkë me aplikimin e rregullave të konkurrencës kur dispozitat në kundërshtim me këto parime janë të pandashme nga funksionimi i skemës.

Në përputhje me parimet e mësipërme, skemat e ndihmës nuk duhet që ta rezervojnë ndihmën, për shembull, ekskluzivisht për shtetasit e vet; të kërkojnë që përfituesit të kenë statusin e sipërmarrjeve kombëtare të krijuara sipas së drejtës tregtare të vendit përkatës (sipërmarrjet e themeluara në një Shtet Anëtar që operojnë në një tjetër me anë të një dege apo agjencie të përhershme duhet të jenë të pranueshme për të përfituar ndihmë; përveç kësaj, ky kriter për agjencinë duhet të jetë i detyrueshëm vetëm në momentin e pagesës së ndihmës); apo që t'i detyrojnë kompanitë e huaja që ofrojnë shërbime të prodhimit të filmave që të anashkalojnë termat dhe kushtet e Direktivës 96/71/EC në lidhje me punëtorët e tyre të dërguar për të punuar në vende të tjera ⁽¹⁾.

Duke pasur parasysh situatën specifike të sektorit evropian të filmit, skemat mbështetëse të prodhimit të filmit mund të bëjnë sa më poshtë:

— të kërkojnë që deri në 160% të shumës së ndihmës dhënë për prodhimin e një veprë të caktuar audiovizuale të shpenzohet në territorin që jep ndihmën, ose

— ta llogarisin shumën e ndihmës së dhënë për prodhimin e një veprë të caktuar audiovizuale si përqindje të shpenzimeve për aktivitetet e prodhimit të filmit në shtetin anëtar që jep ndihmën, zakonisht në rastin e skemave mbështetëse në formën e stimujve tatimorë.

Në të dyja rastet, që projektet e prodhimit të filmave të kenë të drejtën e përfitimit nga këto ndihma, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që një nivel minimal aktiviteti për prodhimin e atyre filmave të zhvillohet brenda territorit të tyre. Megjithatë, ky nivel nuk mund të kalojë 50% të buxhetit të përgjithshëm të prodhimit të filmit. Përveç kësaj, aspekti territorial nuk duhet që në asnjë rast të kalojë 80% të buxhetit të përgjithshëm të prodhimit.

¹ Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 1996 lidhur me dërgimin e punëtorëve jashtë vendit në kuadrin e ofrimit të shërbimeve (OJ L 18, 21.1.1997, f. 1)

Kriteret specifike të vlerësimit sipas nenit 107(3)(d) të TFBE-së

Mbështetja e prodhimit të veprave audiovizuale evropiane dhe marrja e masave për të siguruar ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme për prodhimin dhe për ekspozimin e tyre ka për qëllim që të formësojë identitetet kulturore evropiane dhe forcimin e diversitetit kulturor. Prandaj, qëllimi i ndihmës është promovimi i kulturës. Një ndihmë e tillë mund të jetë në përputhje me Traktatin sipas nenit 107(3)(d) të TFBE-së. Sipërmarrjet në sektorin e prodhimit të filmave dhe programeve televizive mund të përfitojnë edhe nga lloje të tjera ndihme që jepen në bazë të nenit 107(3)(a) dhe (c) të TFBE-së (p.sh. ndihmë rajonale, ndihmë për SME-të, ndihmë për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimi, për trajnime ose për punësim), brenda intensiteteve maksimale të ndihmës në rastin e akumulimit të ndihmës.

Në rastin e skemave të dizajnuara për të mbështetur shkrimin e skenarëve, zhvillimin, prodhimin, shpërndarjen dhe promovimin e veprave audiovizuale të mbuluara nga ky Komunikim, Komisioni do të shqyrtojë kriteret e mëposhtme në lidhje me veprën audiovizive që do të përfitojë nga ndihma për të vlerësuar nëse skema është në përputhje me Traktatin sipas nenit 107(3)(d) të TFBE-së.

Ndihma synon mbështetjen e një produkti kulturor. Çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masa që përmbajtja e prodhimit të mbështetur të jetë kulturore sipas kriterëve kombëtarë përkatëse, nëpërmjet një procesi efikas verifikimi për të shmangur gabimet e dukshme: qoftë nëpërmjet përzgjedhjes së filmave të propozuar, për shembull nga një panel apo nga një person të cilit i është besuar përzgjedhja, ose, në mungesë të një procesi të tillë përzgjedhjeje, përmes përcaktimit të një liste kriteresh kulturore kundrejt të cilave verifikohet çdo vepër audiovizive. Intensiteti i ndihmës në parim duhet të kufizohet në 50% të buxhetit të prodhimit, me synimin për të stimuluar nismat komerciale normale. Intensiteti i ndihmës për produksionet ndërkufitare të financuara nga më shumë se një Shtet Anëtar dhe që përfshijnë producentë nga më shumë se një Shtet Anëtar mund të jetë deri në 60% të buxhetit të produksionit. Veprat e vështira audiovizuale ⁽¹⁾ dhe bashkëproduksionet që përfshijnë vende nga Lista DAC e OECD-së ⁽²⁾ përjashtohen nga këto kufij. Në këtë kontekst, filmat, versioni i vetëm original i të cilëve është në një gjuhë zyrtare të një Shteti Anëtar me një territor, popullsi ose zonë gjuhësore të kufizuar mund të konsiderohen si vepra të vështira audiovizuale.

¹ Si filma të shkurtër, filma nga regjisorë për herë të parë dhe për herë të dytë, dokumentarë ose vepra me buxhet të ulët ose vepra të vështira komercialisht. Sipas parimit të subsidiaritetit, i takon çdo shteti anëtar të vendosë një përkufizim të filmave të vështirë sipas parametrave kombëtarë.

² Lista e DAC tregon të gjitha vendet dhe territoret që kualifikohen për të marrë ndihmë zyrtare zhvillimore. Këto përbëhen nga të gjitha vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme bazuar në të ardhurat kombëtare bruto (GNI) për frymë të publikuar nga Banka Botërore, me përjashtim të anëtarëve të G8, anëtarëve të BE-së dhe vendeve me një datë të caktuar për hyrjen në BE. Lista përfshin edhe të gjitha vendet më pak të zhvilluara (LDC) siç përcaktohen nga Kombet e Bashkuara (http://www.oecd.org/document/45/0,3746,en_2649_34447_2093101_1_1_1_1,00.html)

Në parim, nuk ka asnjë kufi për ndihmën për shkrimin e skenarëve apo për realizimin e filmave. Megjithatë, nëse skenari apo projekti që rrjedh prej asaj ndihme çon përfundimisht në një film, kostot e shkrimit të skenarit dhe më pas të realizimit të filmit përfshihen më pas në buxhetin e produksionit dhe merren parasysh për llogaritjen e intensitetit maksimal të ndihmës për veprën audiovizuale siç përcaktohet në nënparagrafin 2 më sipër.

Kostot e shpërndarjes dhe promovimit të veprave audiovizuale që janë të pranueshme për mbështetje prodhimi mund të mbështeten me të njëjtin intensitet ndihme siç kanë qenë ose siç mund të kishin qenë për prodhimin e tyre.

Përveçse për shkrimin e skenarit, për realizimin, për shpërndarjen ose për promovimin, nuk lejohet dhënia e ndihmës për aktivitete produksioni specifike. Rrjedhimisht, ndihma nuk duhet të rezervohet për pjesë të veçanta të zinxhirit të vlerës së produksionit. Çdo ndihmë e dhënë për prodhimin e një vepre audiovizive specifike duhet të kontribuojë në buxhetin e saj të përgjithshëm. Producenti duhet të jetë i lirë të zgjedhë zërat e buxhetit që do të shpenzohen në shtetet e tjera anëtare. Kjo bëhet për t'u siguruar që ndihma të ketë një efekt stimulues neutral. Caktimi i ndihmës për zëra të veçantë individualë të buxhetit të filmave mund ta kthejë një ndihmë të tillë në një preferencë kombëtare për sektorët që ofrojnë pikërisht ata zëra që e marrin atë ndihmë, gjë që do të ishte jo e pajtueshme me Traktatin.

Shtetet anëtare duhet t'i inkurajojnë dhe t'i mbështesin producentët që ta depozitojnë një kopje të filmit të mbështetur në institucionin e trashëgimisë së filmit të caktuar nga organi financues për ruajtjen e filmave, si dhe për përdorim të specifikuar jokomercial siç bihet dakord me mbajtësin(it) e të drejtës mbi filmin në përputhje me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe pa paragjykim ndaj shpërblimit të drejtë për mbajtësin(it) e të drejtave pas një periudhe kohore të rënë dakord dhe të përcaktuar në marrëveshjen e grantit dhe në mënyrë të tillë që kjo të mos ndikojë në përdorimin normal të filmit.

Ndihma duhet të jepet në mënyrë transparente. Shtetet anëtare duhet të publikojnë të paktën informacionin e mëposhtëm në një faqe interneti të vetme, ose në një uebsajt të vetëm që merr informacion nga disa faqe interneti: tekstin e plotë të skemës së miratuar të ndihmës dhe dispozitat e saj zbatuese, emrin e përfituesit të ndihmës, emrin dhe natyrën e aktivitetit ose të projektit të ndihmuar, shumën e ndihmës dhe intensitetin e ndihmës në raport me buxhetin total të aktivitetit ose të projektit të ndihmuar. Një informacion i tillë duhet të publikohet në internet pasi të jetë marrë vendimi për çmimin, të ruhet për të paktën 10 vjet dhe të jetë i disponueshëm për publikun e gjerë pa kufizime ⁽¹⁾. Modernizimi i kinemave, duke përfshirë edhe dixhitalizimin e tyre, mund të ndihmohet aty ku Shtetet Anëtare mund të justifikojnë

¹ Ky informacion duhet të përditësohet rregullisht (p.sh. çdo gjashtë muaj) dhe duhet të jetë i disponueshëm në formate burimesh të hapura

domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e një ndihme të tillë. Mbi këtë bazë, Komisioni do të vlerësonte nëse skema është në përputhje me Traktatin sipas nenit 107(3)(d) të TFBE-së.

Në përcaktimin nëse respektohet intensiteti maksimal i ndihmës, do të merret parasysh shuma totale e masave të mbështetjes publike të Shteteve Anëtare për aktivitetin ose për projektin e ndihmuar, pavarësisht nëse kjo mbështetje financohet nga burime lokale, rajonale, kombëtare apo nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, fondet e dhëna drejtpërdrejt nga programet e BE-së si MEDIA, pa përfshirjen e Shteteve Anëtare në vendimin për dhënien e çmimit, nuk janë burime shtetërore. Prandaj, ndihma e tyre nuk llogaritet për qëllime të respektimit të kufijve të ndihmës.

MASAT E PËRSHTATSHME

Komisioni propozon si masa të përshtatshme për qëllimet e nenit 108(1) të TFBE-së që shtetet anëtare t'i harmonizojnë skemat e tyre ekzistuese në lidhje me financimin e filmit me këtë Komunikim brenda 2 vjetësh nga botimi i tij në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*. Shtetet Anëtare duhet t'i konfirmojnë Komisionit brenda një muaji nga botimi i këtij Komunikimi në Fletoren Zyrtare se janë dakord me masat e duhura të propozuara. Në mungesë të një përgjigjeje, Komisioni do të konsiderojë se Shteti Anëtar në fjalë nuk është dakord me këtë komunikim.

APLIKIMI

Kjo komunikatë do të zbatohet që nga dita e parë pas botimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Komisioni do ta zbatojë këtë Komunikim për të gjitha masat e ndihmës të njoftuara për të cilat i kërkohet të marrë një vendim pas publikimit të Komunikimit në Fletoren Zyrtare, edhe kur masat e ndihmës njoftohen përpara asaj date.

Në përputhje me njoftimin e Komisionit për përcaktimin e rregullave të zbatueshme për vlerësimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ⁽¹⁾, në rastin e ndihmës së panjoftuar, Komisioni do ta zbatojë:

këtë Komunikim, nëse ndihma është dhënë pas botimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*;

Komunikimin për Kinematografinë të vitit 2001 në të gjitha rastet e tjera.

¹ OJ C 119, 22.5.2002, f. 22.